

401
Erdal Ligji
e Shkret



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI POPULLOR

L I G J

Nr.8150, datë 11.9.1996

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
"PËR UNIFIKIMIN E DISA RREGULLAVE TË TRANSPORTIT AJROR
NDËRKOMBËTAR", NËNSHKRUAR NË VARSHAVË MË 12.10.1929

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën "Për unifikimin e disa rregullave të Transportit Ajror Ndërkombëtar" nënshkruar në Varshavë më 12.10.1929

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARJA E KRYESISË
Margarita QIRKO

Perkthimi I meposhtem (teksti anglishtes) eshte teksti I ratifikuar nga Senati I SH.B.A ne 15 Qershor 1934.

KONVENTA PER UNIFIKIMIN E DISA RREGULLAVE TE TRANSPORTIT NDERKOMBETAR AJROR

Kapitulli I

Qellimi - Perkufizime

Neni 1 .

(1) Kjo konvente do te aplikohet per te gjithë transportin Nderkombetar te personave, bagazheve, apo mallrave qe kryhet me avion kundrejt pageses. Kjo konvente do te jete njesoj e zbatueshme per transportin falas qe kryhet nga nje ndermarrje e transportit ajror.

(2) Ne kete konvente shprehja “ transport nderkombetar “ do te nenkuptoje transportin ne te cilin, sipas kontrates se bere nga palet, vendi I nisjes dhe vendi I destinacionit (pavaresisht nese behet ose jo nje pushim ndermjetes) gjenden ose brenda territoreve te dy paleve kontratuese, ose brenda territorit te nje pale te vetme kontraktuese n.q.se ka nje vend ndalese nen sovranitetin, kontrollin, mandatin apo autoritetin e nje fuqie tjeter, edhe ne rast se kjo Fuqi nuk eshte pale ne kete konvente. Transporti nuk do te konsiderohet si nderkombetar per qellime te kesaj konvente, n.q.se ndermjet territoreve nen sovranitetin, kontrollin, mandatin apo autoritetin e te njejtës Pale kontraktuese nuk gjendet kjo vend ndalese e miratuar.

(3) Per qellime te kesaj konvente, transporti qe do te kryhet nga disa avione te njepasnjeshem do te konsiderohet si nje I pandare, n.q.se do te trajtohet nga palet si nje operim I vetem I miratuar ne formen e nje kontrate te vetme apo nje seri kontratash, dhe nuk do ta humbase karakterin e tij nderkombetar thjesht sepse nje kontrate apo nje seri kontratash do te realizohen teresisht brenda nje territori nen sovranitetin, kontrollin, mandatin apo autoritetin e te njejtës Pale kontraktuese.

Neni 2.

(1) Kjo konvente do te zbatohet per transportin e kryer nga shteti ose nga subjektet legale ne rast se ai ploteson kushtet e vena ne nenin 1.

(2) Kjo konvente nuk do te zbatohet per transportin e kryer sipas kushteve te ndonje konvente nderkombetare postale.

Kapitulli II

Dokumentet e transportit

Seksioni 1.- Bileta e pasagjerit

Neni 3

(1) Ne transportin e pasagjereve transportuesi duhet te leshoje nje bilete pasagjeresh e cila duhet te permbaje keto te dhena :

- (a) vendin dhe daten e leshimit.
- (b) vendin e nisjes dhe te destinacionit.
- (c) vendndalesen e miratuar, me kusht qe transportuesi mund te rezervoje te drejten per te ndryshuar vend ndalesen ne rast nevoje, dhe ne rast se ai e ushtron kete te drejte, kjo nuk do t'ia heqe transportit karakterin nderkombetar.
- (d) emrin dhe adresen e transportuesit.
- (e) nje deklarate qe transporti I nenshtrohet rregullave lidhur me pergjegjesite e vena nga kjo konvente.

(2) Mungesa, parregullsia apo humbja e biletës së pasagjerit nuk do të ndikojë në qenien apo vlefshmërinë e kontratës së transportit, e cila jo më pak duhet t'i nenshtrohet rregullave të kësaj konvente. Megjithatë, n.q. se transportuesi pranon një pasagjer pa bilete, ai nuk duhet të perfitojë nga dispozitat e kësaj konvente të cilat përjashtojnë apo kufizojnë përgjegjësitë e tij.

Seksioni 2 - Kuponi I bagazheve

Neni 4

- (1) Përveç objekteve personale që pasagjeri I mban vete, për transportin e bagazheve transportuesi duhet të leshojë një kupon bagazhi.
- (2) Kuponi duhet të bëhet në dy kopje, njëri për pasagjerin dhe njëri për transportuesin.
- (3) Kuponi duhet të përmbajë keto të dhëna:
 - (a) vendin dhe datën e leshimit.
 - (b) vendin e nisjes dhe të destinacionit.
 - (c) emrin dhe adresën e transportuesit.
 - (d) numrin e biletës së pasagjerit.
 - (e) një deklaratë që bagazhi do t'i jepet mbajtësit të kuponit.
 - (f) numrin dhe peshën e pakove.
 - (g) shumën e vlerës së deklaruar në bazë të nenit 22 (2).
 - (h) një deklaratë që transporti I nënshtrohet rregullave lidhur me përgjegjësitë e vëna nga kjo konventë.
- (4) Mungesa, parregullsia apo humbja e kuponit të bagazheve nuk do të çojë në anulim të kontratës së transportit të cilës jo më pak duhet t'i nënshtrohet rregullave të kësaj konvente. Megjithatë, në rast se transportuesi pranon bagazh pa leshuar një kupon për të, ose në rast se kuponi nuk përmban të dhënat e kaktuara me sipër në pikat (d), (f) dhe (h), ai nuk duhet të përfitojë nga ato dispozita të konventës që përjashtojnë apo kufizojnë përgjegjësitë e tij.

Seksioni 3 - Fatura qe shoqeron mallrat.

Neni 5.

- (1) Transportuesi I mallrave ka te drejten t'i kerkoje derguesit nje dokument te quajtur " fatura e shoqerimit te mallrave "; derguesi nga ana e tij ka te drejten t'i kerkoje transportuesit qe te pranoje kete dokument.
- (2) Mungesa, parregullsia apo humbja e ketij dokumenti nuk duhet te ndikojne ne vlefshmerine apo qenien e kontrates se transportit, e cila sipas dispozitave te nenit 9 duhet te hartohet sipas rregullave te kesaj konvente.

Neni 6.

- (1) Fatura e shoqerimit te mallrave duhet te behet nga derguesi ne 3 kopje origjinale dhe te dorezohet me mallrat.
- (2) Kopja e pare do te emertohet " Per transportuesin " dhe duhet te nenshkruhet nga derguesi. Kopje e dyte do te emertohet " Per marresin " e do te nenshkruhet nga dorezuesi dhe nga transportuesi dhe do te shoqeroje mallin, kopja e trete duhet te nenshkruhet nga transportuesi dhe t'i jepet derguesit pas pranimi te mallrave.
- (3) Transportuesi duhet te nenshkruaje me pranimin e mallit.
- (4) Nenshkrimi (firma) e transportuesit mund te stampohet , ndersa firma e dorezuesit mund te printohet apo stampohet.
- (5) N.q.se me kerkesen e dorezuesit, transportuesi ben faturen e shoqerimit te mallrave, ai do te konsiderohet se veptron ne emer te dorezuesit, pervec rasteve qe provojne te kunderten.

Neni 7.

Transportuesi I mallrave ka te drejte t'i kerkoje dorezuesit te beje fatura te vecanta te shoqerimit te mallit kur ka me teper se 1 pako.

Neni 8.

Fatura e shoqerimit te mallit duhet te permbaje keto te dhena :

- (a) vendin dhe daten e leshimit.
- (b) vendin e nisjes dhe te destinacionit.
- (c) vendndalesat e miratuara, me kusht qe transportuesi rezervon te drejten te ndryshoje vendndalesat ne rast nevojje, dhe ne rast se ai e ushtron kete te drejte.
Ky ndryshim I vendndaleses nuk ia heq transportit karakterin nderkombetar.
- (d) emrin dhe adresen e dorezuesit.
- (e) emrin dhe adresen e transportuesit te pare.
- (f) emrin dhe adresen e marresit, n.q.se e kerkon rasti.
- (g) natyren e mallrave.
- (h) numrin e pakove, metoden e paketimit dhe shenjat e vecanta apo numrat mbi to.
- (I) peshen, sasine, volumin ose dimensionet e mallrave.
- (j) gjendjen e dukshme te mallrave dhe te paketimit.
- (k) tarifen, n.q.se eshte rene dakort, daten dhe vendin e pageses dhe personin qe do ta paguaje.
- (l) n.q.se mallrat do te paguhen pas mberritjes ne destinacion, duhet te shenohet cmimi I mallrave dhe ne rast se eshte e nevojshme shumen e shpenzimeve te perfshira.
- (m) shumen e vleres se deklaruar ne baze te nenit 22 (2).
- (n) numrin e kopjeve te fatures se shoqerimit te mallit.
- (o) dokumentet qe I jane dorezuar transportuesit per te shoqeruar kete fature.
- (p) kohen e fiksuar per kryerjen e transportit dhe nje shenim per rrugen qe do te ndiqet, n.q.se keto probleme jane miratuar nga te dyja palet.
- (q) nje deklarate qe transporti I nenshtrohet rregullave lidhur me pergjegjesite e vena nga kjo konvente.

Neni 9.

N.q.se transportuesi pranon mallra pa faturen e shoqerimit te tyre, apo n.q.se fatura nuk permban te gjitha te dhenat e nenit 8. a) deri te (I) perfshire si dhe (q), transportuesi nuk duhet te perfitoje nga dispozitat e kesaj konvente qe perjashtojne ose kufizojne pergjegjesite e tij.

Neni 10.

- (1) Dorezuesi eshte pergjegjes per korrektesine e te dhenave dhe deklarimeve per mallrat qe ai shenon ne fature.
- (2) Dorezuesi eshte pergjegjes per te gjitha demet qe I shkaktohen transportuesit ose ndonje personi tjeter per arsye te parregullsise, moskorrektesise apo moskompletimit te te dhenave dhe deklarimeve te mesiperme.

Neni 11.

- (1) Fatura e shoqerimit te mallit do te jete aspekti I pare qe evidenton konkludimin e kontrates, pranimin e mallit dhe te kushteve te transportit.
- (2) Deklarimet ne fature qe lidhen me peshen, dimensionet dhe paketimin e mallrave si edhe ato qe lidhen me numrin e pakove do te jene evidenca e pare e fakteve te shenuara; ndersa ato qe lidhen me sasine, volumin dhe kushtet e mallrave nuk perbejne evidence kunder transportuesit, pervecse kur ato sic deklarohet ne fature jane jane kontrolluar nga Ai ne pranine e dorezuesit ose lidhen me gjendjen e dukshme te mallrave.

Neni 12.

Ndalesa ne tranzit.

- (1) Per te kryer detyrimet e tij sipas kontrates se transportit, dorezuesi ka te drejte te zhvendose mallrat duke I cuar ato ne aeroportin e nisjes apo te destinacioni, ose duke I bllokuar ato gjate udhetimit ne cfaredo ulje qe behet, ose te kerkoje qe ato te dergohen ne vendin e destinacionit ose te dergohen ne vendin e destinacionit ose te dergohen tek ndonje person qe nuk eshte marresi I shenuar ne fature, ose te kerkoje qe ato te kthehen ne aeroportin e nisjes. Ai nuk duhet ta ushtroje kete te drejte te terheqjes se mallrave ne ate menyre sa te paragjykoje transportuesin apo derguesit e tjere dhe ai duhet te paguaje shpenzimet qe rrjedhin nga ushtrimi I kesaj te drejte.
- (2) N.q.se transportuesi e ka te pamundur te kryeje keto porosi te derguesit, ai duhet ta informoje kete te fundit menjehere.
- (3) N.q.se transportuesi I bindet porosive te dorezuesit per terheqjen e mallrave pa I kerkuar atij duplikaten e kopjes se leshuar ketij te fundit, atehere transportuesi, pa paragjykuar rimbursimin nga ana e dorezuesit, do te jete pergjegjes per ndonje dem qe mund t'i shkaktohet ndonje personi I cili ligjerisht posedon ate kopje te fatures.
- (4) E drejta qe ka dorezuesi mbaron ne momentin kur fillon e drejta e marresit sipas nenit 13 me poshte. Megjithate, n.q.se marresi refuzon te pranoje faturen apo mallrat, derguesi merr perseri te drejten e terheqjes se mallit.

Neni 13.

Te drejtat e marresit.

- (1) Pervese ne rrethanat qe jepen ne Nenin e mesiperm, marresi ka te drejte qe me mberritjen e mallrave ne vendin e destinacionit t'i kerkoje transportuesit t'i dorezoje atij faturen dhe mallrat kundrejt pagesave dhe ne perputhje me kushtet e transportit te caktuara ne fature.

(2) N.q.se nuk bihet dakort ndryshe, eshte detyra e transportuesit te njoftoje marresin sapo mallrat mberrijne.

Vonesa 7 diteshe - Humbja e supozuar

(3) N.q.se transportuesi pranon humbjen e mallrave, ose n.q.se mallrat nuk kane mberritur 7 dite pas dites qe duhet te kishin mberritur, marresi ka te drejte te vere ne fuqi kunder transportuesit te drejtat qe rrjedhin nga kontrata e transportit.

Neni 14.

Dorezuesi dhe marresi mund te ushtrojne te gjitha te drejtat qe I japin Nenet 12 dhe 13, secili ne emer te tij pavaresisht nense ata veprojne ne interes te vet apo ne interes te te tjereve, me kusht qe te plotesojne detyrimet qe u imponon kontrata.

Neni 15.

Te drejtat ndermjet dorezuesit dhe marresit.

(1) Nenet 12, 13, dhe 14 nuk duhet te cenojne as marredheniet e dorezuesit dhe marresit me njeri - tjetrin as marredheniet e paleve te treta te drejtat e te cileve rrjedhin nga transportuesi (nepermjet dorezuesit) ose nga marresi.

(2) Dispozitat e neneve 12, 13, 14 mund te variojne vetem duke u cilesuar shprehimisht ne faturen e shoqerimit te mallit.

Neni 16.

Dokumentat e Doganes.

(1) Dorezuesi duhet te jape ato te dhena dhe duhet t'i jape ato te dhena dhe duhet t'i bashkengjise fatures ato dokumente qe jane te nevojshme per kryerjen e formaliteteve te doganes, apo policise perpara se mallrat te livrohen tek marresi. Dorezuesi eshte pergjegjes para transportuesit per ndonje dem si rrjedhoje e mungeses,

pamjaftueshmerise apo parregullsise se ketyre dokumentave, pervecse kur demi vjen si pasoje e gabimeve te bera nga transportuesi apo agjentet e tij.

- (2) Transportuesi nuk ka ndonje detyrim qe te shqyrtoje korrektesine apo pamjaftueshmerine e ketyre te dhenave apo dokumenteve.

Kapitulli III

Pergjegjesite e transportuesit.

Neni 17.

Dentimi I pasagjereve.

Transportuesi eshte pergjegjes per dentimet qe shkojne deri ne vdekjen apo plagosjen e pasagjerit apo qofte edhe nje lendim trupor, ne rast se aksidenti ndodh ne bordin e avionit ose gjate operacioneve te ngarkimit dhe shkarkimit.

Neni 18.

Dentimi I mallrave dhe bagazheve

- (1) Transportuesi eshte pergjegjes per dentimet apo humbjet e bagazheve apo mallrave te kontrolluara, n.q. se keto ndodhin gjate transportimit nga ajri.

Perkufizimi I transportimit nga ajri.

- (2) Transportimi nga ajri sipas kuptimit te paragrafit te mesiperm perben kohen gjate se ciles bagazhet apo mallrat jane ne zoterim te transportuesit, si ne aeroport apo ne bordin e avionit, ose ne rastin e nje uljeje jashte aeroportit, ne cfaredo vendi qofte.

(3) Koha e transportimit nga ajri nuk perfshin transportimin me toke, det apo lume te kryer jashte aeroportit. Megjithate, n.q.se ky transportim ndodh gjate kryerjes se nje kontrate per transportimin nga ajri, cdo demtim qe ndodh ne ngarkim - shkarkim apo livrim presupozohet te kete ndodhur gjate transportimit nga ajri (pervecse n.q.se vertetohet e kunderta).

Neni 19.

Demi qe rrjedh nga vonesa.

Transportuesi eshte pergjegjes per demin e shkaktuar nga vonesa ne transportimin nga ajri te pasagjereve, bagazheve apo mallrave.

Neni 20.

Perjashtimi - Te gjitha masat e marra - Pamundesia

(1) Transportuesi nuk eshte pergjegjes n.q.se ai provon se ai dhe agjentet e tij kane marre te gjitha masat e nevojshme per te shmangur demtimet ose n.q.se ishte e pamundur per te te merrte keto masa.

Gabimi ne pilotim, apo ne navigim.

(2) Ne transportimin e mallrave dhe bagazheve transportuesi nuk do te jete pergjegjes nese ai provon se demet u shkaktuan nga nje gabim ne pilotim, ne zoterimin e avionit apo ne navigim dhe se ai e agjentet e tij moren te gjitha masat e nevojshme per te shmangur demet.

Neni 21.
Neglizhenca.

N.q.se transportuesi provon se demtimi u shkaktua ose u be shkas nga neglizhenca e personit te lenduar, Gjykata, ne baze te dispozitave te ligjit te saj, perjashton pjeserisht ose teresisht transportuesin nga pergjegjesia.

Neni 22.

Kufiri I detyrimit - Pasagjeret.

(1) Detyrimi I transportuesit per cdo pasagjer duhet te kufizohet ne shumen 125.000 franga. Atje ku, ne baze te ligjit ne Gjykatën qe shqyrton ceshtjen, demtimi mund te shlyhet ne formen e nje pagese periodike, vlera kapitale ekuivalente nuk duhet te kaloje shumen 125.000 franga. Megjithate, me marreveshje te vecante, transportuesi dhe pasagjeri mund te bien dakort per nje kufi me te larte detyrimi.

Kufiri I detyrimit - Bagazhet dhe mallrat.

(2) Detyrimi I transportuesit ne transportimin e bagazheve dhe mallrave te kontrolluara duhet te kufizohet ne shumen 250 franga/ per kg, n.q.se derguesi nuk ka bere (ne kohen kur pakot I jane dorezuar transportuesit) nje deklararim te vecante te vleres ne livrim dhe te kete paguar nje shume suplementare te nevojshme. Ne kete rast transportuesi duhet te paguaje nje shume qe nuk e kalon shumen e deklaruar, n.q.se nuk provon se ajo shume eshte me e madhe sesa vlera aktuale e asaj te derguesit ne livrim.

Kufiri I detyrimit - Pasuria qe eshte nen kujdesin e vet pasagjereve.

(3) Per sa I perket objekteve per te cilat kujdesen vete pasagjeret, detyrimi I transportuesit duhet te kufizohet ne 5.000 franga per pasagjer.

Standarti I monedhes.

(4) Shumat e permendura me siper I referohen frangave franceze qe perben 65 1/2 miligram ar ne standartin puro prej te nenteqindmijtave. Keto shuma mund te konvertohen ne monedhat kombetare ne dhjeteshe te plota.

Neni 23.

Dispozitat qe I heqin detyrimet transportuesit.

Cdo dispozite qe synon te liroje transportuesin nga detyrimet ose qe fikson nje kufi me te ulet sesa ai I vene ne kete konvente do te jete e paligjshme, por kjo nuk do te nenkuptoje paligjishmerine e krejt kontrates e cila do t'i nenshtrohet dispozitave te kesaj konvente.

Neni 24.

(1) Ne rastet e shqyrtuara ne nenet 18 dhe 19 ku behet fjale per demtimet, cdo veprim mund te ndermerret vetem sipas kushteve dhe kufijve te vena nga kjo konvente.

(2) Dispozitat e paragrafit te mesiperm aplikohen edhe per nenin 17 pa pasur ndonje paragjykim se cilet jane personat qe kane te drejte te bejne padi dha cilat jane te drejtat e tyre respektive.

Neni 25

(1) Transportuesi nuk duhet te perfitoje nga dispozitat e konventes te cilat perjashtojne ose kufizojne pergjegjesite e tij, ne rast se demi shkaktohet nga gabimi I tij I vullnetshem ose nga ndonje veprim, qe sipas ligjit te gjykates ku shqyrtohet ceshtja, konsiderohet te jete ekuivalent me kete gabim te vullnetshem.

(2) Gjithashtu transportuesi nuk duhet te perfitoje nga keto dispozita, ne rast se demi shkaktohet ne te njejtat rrethana nga ndonje agjent I transportuesit.

- (2) Gjithashtu transportuesi nuk duhet te perfitoje nga keto dispozita, ne rast se demi shkaktohet ne te njejtat rrethana nga ndonje agjent I transportuesit.

Neni 26.

Pranimi I mallrave pa ankese.

- (1) Pranimi I bagazheve dhe mallrave pa ankese eshte evidenca e pare se ato jane livruar ne gjendje te mire dhe ne baze te dokumentave te transportit.

Njoftimi per demtimet - 3 dite per bagazhet, 7 dite per mallrat, 14 dite per vonesen.

- (2) Ne rast demtimi, personi I caktuar per livrim duhet te ankohe tek transportuesi menjehere pas zbulimit te demit, dhe me te shumten deri 3 dite nga data e marrjes se bagazheve dhe 7 dite nga data e marrjes se mallrave. Ne rast vonese ankese duhet bere brenda 14 diteve nga data qe bagazhet apo mallrat jane vene ne dispozicionin e tij.

- (3) Cdo ankese duhet te behet me shkrim mbi dokumentin e transportit apo ne nje dokument te vecante dhe te jepet brenda afateve te percaktuara me siper.

- (4) Kur ankese nuk behet brenda afateve, nuk ndermerret asnje veprim kunder transportuesit pervecse ne rast mashtrimi nga ana e tij.

Neni 27.

Ne rast vdekje te personit pergjegjes, asnje veprim per demtimet nuk ndermerret kunder atyre qe ligjerisht perfaqesojne pasurine e tij.

Neni 28.

Juridiksioni dhe procedura.

- (1) Ne rast demtimesh, padia sillet para Gjykates se vendit ku banon transportuesi ose ne vendin ku eshte bere kontrata apo ne vendin e destinacionit.

- (2) Ceshtjet e procedures zgjidhen sipas ligjit te Gjykates ku shqyrtohet rasti.

Neni 29.

- (1) E drejta kunder demtimeve skadon n.q.se padia nuk sillet ne Gjykate brenda dy vjeteve nga data e mberritjes ne destinacion, nga data kur avioni duhet te kishte mberritur, ose nga data ne te cilin transportimi ndaloi.
- (2) Metoda e llogaritjes se periudhes se kufizimit do te percaktohet nga ligji I Gjykates ku shqyrtohet rasti.

Neni 30.

Padite kunder transportuesve.

- (1) Ne rastet kur transporti kryhet nga disa transportues sipas perkufizimit te paragrafit te 3 te nenit 1, secili transportues qe pranon pasagjere, bagazhe apo mallra do t'i nenshtrohet rregullave te kesaj konvente, dhe do te konsiderohet si njeri nga palet kontraktuese ne kontraten e transportit per aq sa kontrata trajton ate pjese te transportimit qe eshte kryer nen mbikqyrjen e tij.
- (2) Ne rast transporti te kesaj natyre pasagjeri ose nje perfaqesues I tij mund te ngrejne padi vetem kunder transportuesit qe kreu transportimin gjate te cilit aksidenti ndodhi, pervec rastit ku me marreveshje te vecante, transportuesi I pare ka marre pergjegjesine per gjithe udhetimin.
- (3) Per sa I perket bagazheve apo mallrave, pasagjeri apo dorezuesi ka te drejten e padise kunder transportuesit te pare, ndersa ky pasagjer apo marresi ka te drejten e padise kunder transportuesit te fundit, dhe pervec kesaj secili prej tyre mund te beje padi kunder transportuesit I cili kreu transportimin gjate te cilit ndodhi humbja, demtimi apo vonesa. Keta transportues jane bashkarisht apo vec e vec pergjegjes kundrejt pasagjerit, dorezuesit apo marresit.

Kapitulli IV.

Neni 31

Dispozitat lidhur me transportin e kombinuar nga ajri, toka dhe deti.

(1) Ne rastin e transportit te kombinuar te kryer pjeserisht nga ajri dhe pjeserisht nga ndonje mjet tjetër transporti, dispozitat e kesaj konvente do te aplikohen vetem per transportimin nga ajri, me kusht qe transportimi nga ajri te jete brenda kushteve te Nenit 1.

(2) Kjo konvente nuk I pengon palet ne rastin e transportit te kombinuar, qe te perfshijne ne dokumentet e transportimit nga ajri kushte lidhur me mjetet e tjera te transportit, me kusht qe dispozitat e kesaj konvente te mbahen parasysh per sa I perket transportimit nga ajri.

Kapitulli V

Dispozita finale.

Neni 32

Marreveshjet qe cenojne rregullat e konventes jane te deklaruar si te paligjshme.

Cdo klauzole e futur ne kontrate dhe te gjitha marreveshjet e vecanta te perfshira ne te perpara se te ndodhte demtimi, e me ane te te cilave palet synonin te cenonin rregullat e vendosura nga kjo konvente si duke I quajtur te ligjshme ashtu edhe duke ndryshuar rregullat persa I perket juridiksionit, do te konsiderohen pa vlere ligjore.

Arbitrimet - Kur lejohen

Per transportin e mallrave klauzolat e arbitrimit do te lejohen, sipas kesaj konvente, n.q.se arbitrimi ndodh brenda njerit nga juridiksionet e referuara ne paragrafin e pare te nenit 28.

Neni 33.

Kjo konvente nuk e pengon transportuesin qe te refuzoje futjen ne ndonje kontrate transporti apo qe te imponoje cfaredolloj rregullash qe nuk bien ndesh me dispozitat e kesaj konvente.

Neni 34

Fluturimet eksperimentale dhe te jashtezakonshme.

Kjo konvente nuk do te zbatohet per transportin nderkombetar nga ajri te kryer per prova ekspementale me qellim qe te vendosen linja te rregullta te navigacionit ajror, ashtu si nuk do te aplikohet ne rrethana te jashtezakonshme jashte kuadrit te nje biznesi te nje shoqerie ajrore.

Neni 35.

Perkufizimi “ Ditet “

Shprehja “ ditet “ kur perdoret ne kete konvente do te nenkuptoje dite kalendarike, jo dite pune.

Neni 36.

Kjo konvente eshte hartuar ne Frengjisht ne mje kopje te vetme e cila do te mbetet e depozituar ne arkivat e Ministrise se Jashtme te Polonise dhe nje kopje e certifikuar do te dergohet nga Qeveria Polake tek Qeverite e cdo pale kontraktuese.

Neni 37.

(1) Kjo konvente do te ratifikohet. Instrumentet e ratifikimit do te depozitohen ne arkivat e Ministrise se Jashtme te Polonise, e cila do te informoje per depozitimn Qeverite e cdo pale kontraktuese.

(2) Sapo kjo konvente te ratifikohet nga pese pale kontraktuese, ajo do te hyje ne fuqi ndermjet tyre ne ditën e nentëdhjetë pas depozitimit te ratifikimit te peste. Pas kesaj ajo do te hyje ne fuqi ndermjet paleve kontraktuese qe e kane ratifikuar dhe pales kontraktuese qe depoziton instrumentin e saj te ratifikimit ne ditën e 90 - te pas depozitimit.

(3) Qeveria e Republikës se Polonisë ka per detyrë te njoftoje Qeverite e cdo pale kontraktuese per datën qe kjo konvente hyn ne fuqi si edhe per datën e depozitimit te cdo ratifikimi.

Neni 38.

(1) Pas hyrjes se saj ne fuqi, kjo konvente do te mbetet e hapur per aderim nga cdo shtet.

(2) Aderimi do t'i njoftohet Qeverise Polake, e cila do te informoje Qeverite e cdo pale kontraktuese.

(3) Aderimi do te jete I efektshem nga dita e 90 - te pas njoftimit te bere prane Qeverise Polake.

Neni 39.

(1) Cdo pale kontraktuese mund te terhiqet nga kjo konvente me ane te nje njoftimi drejtuar Qeverise Polake, e cila menjehere duhet te informoje Qeverite e seciles pale kontraktuese.

(2) Terheqja do te behet e efektshme 6 muaj pas njoftimit dhe do te veproje vetem per sa I perket pales qe e kerkon ate.

Neni 40.

(1) Cdo pale kontraktuese muns te deklaraje ne kohen e nenshkrimit, depozitimit apo aderimit, se pranimi qe I ben kesaj konvente nuk eshte I vlefshem per kolonite e saj, protektoratet, territoret nen mandat apo ndonje territor tjeter nen sovranitetin, autoritetin apo kontrollin e saj.

(2) Cdo pale kontratuese mund te aderoje vecmas ne emer te kolonise te saj, protektorateve, territoreve nen mandat, apo te territoreve te tjra nen sovranitetin, autoritetin e kontrollin e saj, te cilat jane perjashtuar nga deklarimi I pare.

(3) Cdo pale kontratuese mund te terhiqet nga kjo konvente, ne perputhje me dispozitat e saj, vecmas ose per te gjitha apo nje nga kolonite e saj, protektoratet, territoret nen mandat apo cdo territor tjeter nen sovranitetin, autoritetin apo kontrollin e saj.

Neni 41.

Cdo pale kontratuese ka te drejte qe jo me heret se dy vjet pas hyrjes ne fuqi te kesaj konvente te kerkoje mbledhjen e nje Konference Nderkombetare per te shqyrtuar permiresimet qe mund t'i behen kesaj konvente. Per kete qellim, ajo do te komunikojte me Qeverine Franceze e cila do te marre masat e nevojshme per pergatitjet e kesaj konference.

Kjo konvente realizuar ne Varshave me 12 Tetor 1929, do te mbetet e hapur per nenshkrim deri ne 31 Janar 1930.

Protokoll Shtese

(Duke iu referuar nenit 2)

Palet kontratuese I rezervojne vetes te drejten te deklarojne ne kohen e ratifikimit apo aderimit, se paragrafi I pare I Nenit 2 te kesaj konvente nuk do te zbatohet per transportin nderkombetar nga ajri te kryer direkt nga shteti, kolonite e saj, protektoratet, territoret nen mandat, apo nga cdo territor nen sovranitetin, kontrollin e autoritetin e tij.